

20231292389

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË HUAMARRJES I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA NGA BANKA EUROPIANE E
RINDËRTIMIT DHE ZHVILLIMIT SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I AKSIT TË RI DHE RIKONSTRUIMI I
AKSIT EKZISTUES BELAKOVÇ - KRIVA PALLANKË - PJESA LINDORE E LINJËS
HEKURUDHORE TË KORRIDORIT VIII, FAZA 2”**

Neni 1

Në Ligjin e Huamarrje të Republikës së Maqedonisë me Hua nga Banka Europiane e Rindërtimit dhe e Zhvillimit sipas Marrëveshjes së huas për financimin e projektit “Ndërtimi i aksit të ri dhe rikonstruimi i aksit ekzistues Belakovc - Kriva Pallankë - pjesa lindore e linjës hekurudhore të Korridorit VIII, faza 2” (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 178/14 dhe numër 10/15) në titullin e ligjit, fjalët “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët “Republika e Maqedonisë së Veriut”, ndërsa fjalët “Projekti për ndërtimin e aksit të ri dhe rikonstruimin e aksit ekzistues Belakovc - Kriva Pallankë - pjesa lindore e linjës hekurudhore të Korridorit VIII, faza 2” zëvendësohen me fjalët “Projekti për ndërtimin e aksit lindor të Korridorit hekurudhor VIII, nga Kumanova në Kriva Pallankë dhe finalizimin e përmirësimit të linjës hekurudhore të Korridorit X”.

Neni 2

Në nenet 4, 5, 6 dhe 7 fjalët “Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Maqedonisë” – Shkup” zëvendësohen me fjalët “Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup”.

Neni 3

Neni 7-a ndryshohet si në vijim:

“Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve të kryera ndaj Ndërmarrjes Publike të Infrastrukturës Hekurudhore Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, të dedikuara për realizimin e projektit për ndërtimin e aksit lindor të Korridorit hekurudhor VIII, nga Kumanova në Kriva Pallankë dhe finalizimin e përmirësimit të linjës hekurudhore të Korridorit X, i financuar nga Marrëveshja e huas sipas nenit 2 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes së tatimit paraprak.

Importi i mirave/mallrave të kryera nga “Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup”, të dedikuara për realizimin e projektit për ndërtimin e aksit lindor të Korridorit hekurudhor VIII, nga Kumanova në Kriva Pallankë dhe finalizimin e përmirësimit të linjës hekurudhore të Korridorit X, i financuar nga Marrëveshja e huas sipas nenit 2 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrimet e importit dhe akciza për energjensat dhe tatimi mbi automjetet motorike.

Për qarkullimin e kryer ndaj Ndërmarrjes Publike të Infrastrukturës Hekurudhore - Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup, të dedikuar për realizimin e projektit për ndërtimin e aksit lindor të Korridorit hekurudhor VIII, nga Kumanova në Kriva Pallankë dhe finalizimin e përmirësimit të linjës hekurudhore të korridorit X, të financuar nga Marrëveshja e huas sipas nenit 2 të këtij ligji, me çka është debitor tatimor në përputhje me nenin 32 pika 4 dhe nenin 32-a të Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, lirohet nga detyrimi për të llogaritur dhe paguar tatimin mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor i cili kryen qarkullim, respektivisht që është i liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të të mirës ose të shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë duhet ta shënojë edhe emërtimin e projektit dhe emërtimin e Marrëveshjes së huasë sipas neni 2 të këtij ligji.

Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës - Hekurudhore Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup gjatë importimit të të mirave të liruara në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, organit kompetent doganor domosdoshmërisht i dorëzon kopje të marrëveshjes së huasë sipas neni 1 të këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë destinuar për realizimin e “Projektit për ndërtimin e aksit lindor të korridorit hekurudhor VIII, nga Kumanova në Kriva Pallankë dhe finalizimin e përmirësimit të linjës hekurudhore të Korridorit X”, të financuar me Marrëveshjen e huas sipas neni 2 të këtij ligji.

Neni 4

Pas neni 7-a, shtohet nen i ri 7-b, si në vijim:

“Neni 7-b

Të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të neni 7-a paragrafi 2 të këtij ligji, në afat prej tre viteve nga importi, nuk mund të tjetërsohen, t’i jepen në shfrytëzim dikujt tjetër, të huazohen ose ndryshe të shfrytëzohen për qëllime tjera dhe jo për ato që janë liruar nga pagesa e detyrimeve importuese, para se të jenë paguar detyrimet importuese. Këto nuk guxojnë të jepen si kolateral, të huazohen ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para përfundimit të afatit sipas paragrafit 1 i këtij neni, të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të neni 7-a paragrafi 2 të këtij ligji, ka për qëllim t’i shfrytëzojë për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat janë liruar nga pagesa e detyrimeve importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor te organi doganor.

Vlerën e borxhit doganor sipas paragrafit 2 i këtij neni, organi doganor e llogarit në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve që ishin të vlefshme në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, vlera e borxhit doganor llogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës malli është liruar nga pagesa e detyrimeve importuese.”

Neni 5

Në gjithë tekstin e ligjit fjalët “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët “Republika e Maqedonisë së Veriut”, ndërsa fjalët “Projekti “Ndërtimi i aksit të ri dhe rikonstruimi i aksit ekzistues Belakovc - Kriva Pallankë - pjesa lindore e linjës hekurudhore të Korridorit VIII, faza 2”” zëvendësohen me fjalët “Projekti për ndërtimin e aksit lindor të Korridorit hekurudhor VIII, nga Kumanova në Kriva Pallankë dhe finalizimin e përmirësimit të linjës hekurudhore të Korridorit X”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republika e Maqedonisë së Veriut.